REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 75/12 Data: 06.09.2012
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 75/12
Datë 06.09.2012

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 04.09.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për mos aprovimin/akreditimin e Qendrës për Aftësim Profesional, Dituria Prizren, për këtë/o kualifikime:

   1.1. Instalues i ngrohjes qendrore; niveli i KKK-së: (III)

Për të fituar aprovimin/akreditimin QAP "Dituria" i rekomandohet që ti plotësoj këto kushte si në vijim:

- Zhvillimi i kurrikulit (hartimi i përshkruesve të moduleve) për Instalues të ngrohjes qendrore;
- Krijimi i hapësirave (punëtorive për demonstrimin e pjesës praktike);
- Sigurimi i pajisjeve, veglave dhe mjeteve të nevojshme për demonstrim e pjesës praktik (nga një post pune për kandidat);
- Sigurimi i pajisjeve personale mbrojtëse për kandidatet të cilët do të vijojnë kualifikimin;
- Përzgjedhja e personelit të përhershëm në ofrimin e kualifikimit (Instruktorëve të trajnimit);
- Hartimi i manualit të trajnimit – doracakut për pjesëmarrësit në trajnim;
- Hartimi i procedurave, udhëzimeve të nevojshme për punë;
- Ndërtimi i një sistemi të vlerësimit të kandidatëve që nga niveli hyrës deri në vlerësimin përfundimtar;

- Përshkrimi i vendit të punës për stafin e përzgjedhur;
- Pas krijimit të punëtorive/ hapësirave, pajisjeve dhe veglave të nevojshme - përgatitja/ vendosja e udhëzimeve për përdorimin e pajisjeve;
- Vendosja e shenjave të sigurisë në vende të dukshme;
- Pajisja me pajisje të nevojshme për siguri në punë (kutia e ndihmës së parë dhe aparatet për zjarr fikje);
- Trajnimi i personelit për vlerësimin e të arriturave të kandidatëve;
- Trajnimi i personelit në sigurimin e brendshëm të cilësisë;
- Të bëhet standardizimi i formularëve te cilët përdoren për kompletim te dokumentacionit;
- Të zhvillohen instrumentet e vlerësimit (listë kontrolli, teste për vlerësim të pjesshëm dhe vlerësim përmbledhës);
- Të hartohet kodi i sjelljes për stafin;
- Të zhvillohet kodi i sjelljes për kandidat;
- Të zhvillohet instrumenti për monitorimin e mësimdhënies;
- Të azhurnohet forma e Certifikatës;
- Të ndërtohet një sistem i brendshëm i dokumentit te të dhënave;
- Te zhvillohen procesverbale për takime të brendshme dhe të jashtme;
- Të zhvillohet orari javor i trajnimit (në të cilën përfshihet plani ditor i punës);
- Të krijohet dosja për kandidatet në trajnim;
- Të zhvillohet formulari për monitorimin e punës së Instruktorëve;
- Të kompletohet dosja për vlerësimin e personelit;

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 04.09.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:
-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

4. Vendimi u dërgohet:

- "QAP" "Dituria" Prizren;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi

REPUBLIKA E KOSOVËS * AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE * NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY * NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE * REPUBLIKA KOSOVA *